

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7911
E martë, 22 tetor 2024
Çmimi 0.50

ÇKAPJA E SHTETIT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

O'BRIEN TAKOHET ME KURTIN NË PRISHTINË, TEMË DISKUTIMI ASOCIACIONI

FAQE 4-5



Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, është takuar të hënën në Prishtinë me kryeministrin e

Kosovës, Albin Kurti. Takimi është zhvilluar në zyrën e kryeministrit. Ata kanë biseduar për zhvillimet në vendin tonë, raportet Kosovë - ShBA

dhe procesin e dialogut me Serbinë, veçanërisht për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

ARRESTOHET ISH-PRESIDENTI I SHQIPËRISË, ILIR META

F. 3



FILLON EDICIONI I 10 I SHKOLLËS DIPLOMATIKE PËR DIPLOMATË TË RINJ

F. 7



AKTUALE



FETHULLAH GULENI, RIVALI I ERDOGANIT, VDIQ NË SHBA F. 2

SHUKRI BUJA THOTË SE ËSHTË FTUAR PA DËSHIRËN E TIJ NGA SPECIALJA NË HAGË F. 3

QYTETI I YONKERSIT NË SHBA NDERON HARADINAJN F. 5

EKONOMI



NË PRISHTINË HAPET PANAIRI AGRI-RINNEW 2024 F. 5

KEDS-I U BËNË THIRRJE STUDENTËVE DHE NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË APLIKOJNË NË KEDS ACADEMY XII F. 7

SPORT



URIM ZENELAJT I NDALOHET BASKETBOLLI PAS PROBLEMEVE ME ZEMËR F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Fethullah Guleni, rivali i Erdoganit, vdiq në ShBA

NJU-JORK, 21 TETOR - Kleriku turk Fethullah Gulen ka vdekur në moshën 83-vjeçare në Shtetet e Bashkuara. Guleni, dikur aleat i presidentit turk Recep Tayyip Erdogan, ishte akuzuar për orkestrimin e grusht-shtetit të dështuar në Turqi më 2016. Disa burime, përfshirë ueb-faqen Herkul, që publikon predikimet e Gulenit, qeveria turke, CNN Turk dhe Fondacioni për Dialog dhe Arsim - organizatë e lidhur me lëvizjen e Gulenit në Gjermani - konfirmuan më 21 tetor se Guleni ka vdekur një ditë më parë. "Mësuesi ynë vdiq më 20 tetor 2024 në orën 21:20 në spitalin ku për një kohë po trajtohej", tha uebfaqja Herkul në një postim në X më 21 tetor, duke shtuar se mjekët e tij do të dalin me një deklaratë lidhur me këtë çështje



"në orët në vijim".

Kjo uebfaqe nuk tregoi se për çfarë po trajtohej Guleni.

Ai kishte jetuar në mërgim në ShBA që nga viti 1999 dhe i ishte hequr shtetësia turke më 2017.

CNN Turk citoi nipin e Gulenit, që

konfirmoi njoftimin e uebfaqes Herkul, ndërkaq Ercan Karakoyun, kryetari i Fondacionit për Dialog dhe Arsim, po ashtu tha se Guleni vdiq të dielën. Grusht-shteti i dështuar kundër Erdoganit dhe qeverisë së tij ishte

një pikë kthese për shtetin. Afër 250 persona u vranë, kur ushtarët e rebeluar rrëmbyen avionë, tanke dhe pajisje të tjera të rënda ushtarake, teksa tentuan ta rrëzonin presidentin nga pushteti. Kjo ngjarje nxiti qeverinë turke që të shpallte luftë kundër rrjetit të Gulenit, e njohur si Hizmet, që në shqip do të thotë shërbim, duke thënë se ai është përgjegjës për puçin, akuzë e mohuar nga Guleni.

Turqia e konsideron organizatë terroriste lëvizjen Hizmet. Kjo lëvizje ka ndikim dhe kryesisht është e përfshirë në aktivitete arsimore dhe promovon shoqërinë civile.

Ministri i Jashtëm i Turqisë, Hakan Fidan, duke konfirmuar raportimet e inteligjencës turke, tha se Guleni ka vdekur, duke e

përkthuar atë si udhëheqës "të një organizate të errët".

Pas puçit të dështuar, mijëra persona u arrestuan në Turqi dhe tensionet u rritën mes Ankarasë dhe çdo shteti që kishte lidhje me Gulenin, edhe pse shumica e rrjetit të tij ka shkolla private.

Në vitet e fundit ka pasur raportime që qytetarë turq të akuzuar për lidhje me Gulenin janë arrestuar dhe dërguar në Turqi.

Në mars të vitit 2018 Kosova arrestoi dhe dëboi gjashtë shtetas turq, që kishin punuar në shkollën private "Mehmet Akif" në Prishtinë.

Të gjithë të arrestuarit, ndërkohë, janë përballur me procese gjyqësore në Turqi dhe në fund janë dënua gjithsej me 56 vjet dhe 7 muaj e gjysmë burgim.

ShBA-ja kërkon që lufta Izrael - Hezbollah të përfundojë "sa më shpejt që është e mundur"

WASHINGTON, 21 TETOR - Shtetet e Bashkuara kanë thënë të hënën se kërkojnë që lufta Izrael - Hezbollah të përfundojë "sa më shpejt që është e mundur", teksa shtojnë përpara një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, që i kërkon grupit të armatosur të tërhiqet prej jugut të Libanit.

Hezbollahu, grup militant dhe parti politike që kontrollon pjesën më të madhe në jug të Libanit, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, derisa Bashkimi Evropian e ka në listë të zezë vetëm krahun e armatosur, por jo partinë e cila ka ulëse në Parlamentin e Libanit.

I dërguari amerikan Amos Hochstein ka zhvilluar bisedime me kryetarin e Parlamentit të Libanit, Nabih Berri - aleat i Hezbollahut - në Bejrut, teksa tenton t'i japë fund luftës së nisur që gati një muaj, e cila

ka vrarë më shumë se 1 470 njerëz në Liban. "Lidhja e të ardhmes së Libanit me konflikte të tjera në rajon nuk ka qenë dhe as nuk është në interesin e njerëzve të Libanit", ka thënë Hochstein, duke iu referuar kërkesës kryesore të Hezbollahut, që secili armëpushim në Liban të jetë i lidhur me dhënien fund të luftës në Gazë.

Hochstein ka thënë, po ashtu, se derisa Rezoluta e OKB-së, 1701, e cila u ka dhënë fund luftimeve në mes të Izraelit dhe Hezbollahut më 2006, duhet të jetë bazë për një armëpushim të ri, palët nuk kanë bërë mjaftueshëm për ta zbatuar atë.

Sipas Rezolutës 1701, vetëm ushtria e Libanit dhe forca paqeruajtëse e OKB-së, UNIFIL, mund të pozicionohen në zonat në jug të lumit Litani të Libanit, që gjendet afër kufirit me Izraelin.

Pavarësisht prej rezolutës, Hezbollahu ka pasur prani në jug të Libanit dhe në tetor të vitit të kaluar ka nisur të gjuajë raketa drejt Izraelit, si shenjë mbështetjeje për aleatin palestinez Hamasin, grup i shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe fuqive tjera.

Javën e kaluar kryeministri i Libanit, Najib Mikati, ka thënë për agjencinë e lajmeve AFP, se qeveria e tij është e gatshme ta forcojë praninë e ushtrisë në jug të Libanit nëse arrihet armëpushimi.

Mirëpo Hezbollahu, grup që mbështet nga Irani, refuzon të çarmatoset qysh prej luftës civile të periudhës 1975-1990, dhe ka sasi të konsiderueshme të armëve në këtë shtet me ndasi të mëdha politike dhe ushtri të dobët.

Shkëmbimet e sulmeve raketore në kufirin e Libanit kanë nisur pas nisjes së luftës së Izraelit në Gazë më



7 tetor të vitit të kaluar.

Lufta është nxitur nga sulmet e Hamasit në jug të Izraelit, duke lënë mbi 1 200 njerëz të vrarë dhe duke marrë 240 pengje tjera.

Si pasojë e ofensivës izraelite në Gazë janë vrarë më shumë se 42 000 palestinezë, kryesisht civilë, sipas autoriteteve shëndetësore

palestineze.

Në shtator Izraeli e ka zgjeruar luftën edhe në Liban, me qëllim të shkatërrimit të kapaciteteve të Hezbollahut në zonën kufitare.

Hezbollahu, në anën tjetër, është zotuar se do ta vazhdojë luftën derisa të arrihet një armëpushim në Gazë.

Gjysma e moldavianëve votojnë për integrimin në BE

KISHINAU, 21 TETOR - Rezultatet tregojnë se presidentja proevropiane Maia Sandu ka fituar raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale në Moldavi dhe do të përballet në balotazh, ndërkaq referendumi për integrimin në Bashkimin Evropian u kthye në favor të kampit "po" mëngjesin e 21 tetorit.

Me më shumë se 99.37 për qind të votave të numëruara, afër 50.38 për qind e moldavianëve kanë votuar me "po" në referendum dhe 49.62 për qind "jo". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tha më 21 tetor se referendumi i mbajtur një

ditë më parë, së bashku me zgjedhjet presidenciale, është i vlefshëm sepse është arritur pragu i pjesëmarrjes. "Komisioni do ta paraqesë raportin e rezulttit të referendumit te Gjykata Kushtetuese, e cila duhet që brenda 10 ditësh t'i konfirmojë apo mohojë rezultatet", tha komisioni.

Rezultati përfundimtar i referendumit, që deri natën vonë ishte në favor të atyre që kundërshtojnë integrimin në bllokun evropian, duket se u ndikua nga votuesit nga diaspora e fuqishme e Moldavisë.



Ndërkaq, në orët e para të 21 tetorit, presidentja Sandu tha përmes një deklaratë se votimet

ishin nën një sulm "të paprecedent" nga "grupet kriminale" që tentuan të blinin

qindra mijëra vota në përpjekje "për ta minuar procesin demokratik".

Me më shumë se 98 për qind të votave të numëruara, Sandu është e para me 42.07 për qind të votave dhe në raundin e dytë do të përballet me socialistin prorus Alexandr Stoianoglo, i cili ka fituar 26.31 për qind të votave.

Raundi i balotazhit do të mbahet më 3 nëntor.

Ndërkaq, rezultati i referendumit është shumë më i ngushtë, pasi 50.1 për qind e votave të numëruara janë për "jo", ndërkaq 49.9 për "po".

Arrestohet ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta

TIRANË, 21 TETOR - Kryetari i Partisë së Lirisë në Shqipëri, Ilir Meta, është arrestuar me urdhër të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK) më 21 tetor. Meta kishte shërbyer në pozitën e presidentit të Shqipërisë nga viti 2017 deri më 2022. Përveç që ka mbajtur pozitën e presidentit, Meta kishte qenë edhe kryeministër, kryetar Kuvendi dhe ministër i Jashtëm.

Policia dhe SPAK-u ende nuk kanë dalë zyrtarisht me ndonjë njoftim për shtyp lidhur me arrestimin e Metës. Meta kishte njoftuar në një konferencë për medie në orën 13:40 dhe ishte duke udhëtuar drejt selisë së partisë së tij kur është arrestuar. Ish-bashkëshortja e Ilir Metës, Monika Kryemadhi, ka shkruar në rrjetet sociale se nuk është në dijeni se ndaj saj është vendosur masa e sigurisë “detyrim paraqitje”, siç është raportuar në mediet në Shqipëri, as për masën e sigurisë “arrest me burg” për Metën. “Unë ende nuk kam dijeni mbi një vendim gjykatë që do të vendoste masa sigurie mbi mua apo babanë e fëmijëve të mi. Sapo të

njoftohem për këto vendime të drejtësisë do të përgjigjem me të gjitha hapat ligjorë dhe publikë. Persekutimi nga drejtësia si armë ndaj kundërshtarit politik, si dhe gjyqi publik që po na bëhet, nuk ndalon opozitën në betejat pa kompromis për ta mbrojtur interesin publik”, shkroi Kryemadhi në “Facebook”.

Zëdhënësi i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi, e cilësoi si “akt të papërgjegjshëm” arrestimin e Metës, duke thënë se SPAK-u me këto veprime po tenton “ta eliminojë opozitën”. “Arsyet e arrestimit të tij lidhen me qëndrimin që ka mbajtur në mbrojtje të çështjes kombëtare”, tha Blushi.

Ndërkaq ish-kryeministri demokrat Sali Berisha mbajti në një konferencë për medie sapo ndodhi arrestimi i Metës. Berisha e cilësoi si “persekutim” arrestimin e Metës. “Nuk kanë publikuar asnjë fakt për Ilir Metën. Persekutimi i Metës është vetëm politik. U zbatua urdhri politik i [kryeministrit të Shqipërisë] Edi Ramës. Është radha jonë”, u shpreh Berisha, pasi u pyet nga gazetarët për këtë zhvillim.



Ish-presidenti Ilir Meta ishte paraqitur në SPAK në qershor të këtij viti. Atëbotë ai bëri akuza të rënda në drejtim të kreut të këtij institucioni, Altin Dumani. Pasi u mor në pyetje, Meta deklaroi për mediet se u pyet për tri orë

“për gjëra të kota” që, sipas tij, nuk kishin lidhje me të, por kishin të bënin me veprimet e të tjerëve. Ai, po ashtu, deklaroi se u pyet për pasurinë dhe theksoi se me këtë çështje merrej bashkëshortja e tij, Monika

Kryemadhi, me të cilën janë në proces divorci. Në SPAK ka qenë dhe Monika Kryemadhi, e cila, ndryshe nga Meta, nuk sulmoi prokurorët e SPAK-ut, por tha se ata po bëjnë punën e tyre.

Shukri Buja thotë se është ftuar pa dëshirën e tij nga Specialja në Hagë

PRISHTINË, 21 TETOR - Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja, ka njoftuar të dielën se ka udhëtuar për në Holandë, për t'u paraqitur “pa dëshirën” e tij para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë. “Me ftesë nga Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë, sot pa dëshirën time, me ftesë të detyruar të paraqitjes, udhëtova për në Hagë”, ka shkruar Buja në “Facebook”.

Buja, ish-pjesëtar i Ushtrisë së atëhershme Çlirimtare të Kosovës (UÇK), nuk tregoi se në çfarë cilësie u thirr nga Gjykata Speciale. “UÇK ishte e shenjtë. Ishte kundër pushtuesit. Falë luftës së saj të armatosur dhe falë përkrahjes së aleatëve, në veçanti nga ShBA-ja, ne e gëzojmë lirinë sot. Lufta çlirimtare solli lirinë dhe pavarësinë që shumë po e gëzojnë sot, ndërsa bijtë më të mirë të këtij



vendi u akuzuan dhe po mbahen padrejtësisht në burg”, ka shkruar ai.

Kjo nuk është hera e parë që Buja thirret për t'u paraqitur para Gjykatës Speciale në Hagë, e cila funksionon sipas ligjeve të

Kosovës, pasi në korrik të vitit 2019 ai ishte intervistuar si i dyshuar. Shukri Buja përmendet në aktakuzën e ndryshuar më 2022 të Dhomave të Specializuara të Kosovës në rastin kundër katër ish-krerëve të UÇK-së, ish-

presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, të dyshuar për krime lufte gjatë viteve 1998-2000.

Aktakuza pretendon se Shukri Buja ka qenë pjesë e “ndërmarrjes së përbashkët kriminale” sikurse “Azem Syla, Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rrustem Mustafa, Latif Gashi dhe udhëheqës të tjerë politikë dhe ushtarakë të UÇK-së”.

Në aktakuzë thuhet se Buja, ish-komandant i UÇK-së për zonën e Nerodimës, “mori pjesë së bashku me Fatmir Limajn dhe me shumë pjesëtarë të UÇK-së në arrestimin dhe mbajtjen e njerëzve në Llapushnik” mes prillit dhe korrikut të vitit 1998.

Ndërkohë, në Dhomat e Specializuara është duke u

zhvilluar rasti gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët akuzohen kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Të gjithë janë deklaruar të pafajshëm.

Deri më tani Dhomat e Specializuara kanë shqiptuar dënime për pengim të drejtësisë ndaj ish-krerëve të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, të cilët vitin e kaluar u liruan me kusht.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Hamza vazhdon të marrë sugjerime nga qytetarët, në Podujevë premtion vende pune dhe rritje pagash

PODUJEVË, 21 TETOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër, Bedri Hamza, ka zhvilluar punëtorinë e radhës me qytetarë në qytetin e Podujevës. Edhe në Podujevë Hamza ka marrë ide dhe sugjerime të vlefshme në kuadër të vizionit dhe përkushtimit të tij për ta ndërtuar programin qeverisës në bashkëpunim me qytetarët.

“Programi, për me qenë për qytetarët dhe me i adresu nevojat e tyre mirë, duhet me shku prej poshtë lart”, ka thënë Hamza.

Në këtë punëtori disa nga kërkesat e qytetarëve ndaj Hamzës ishin hapja e vendeve të reja të punës, rritja e pensioneve dhe pagave konform rritjes së çmimeve, tërheqja e investimeve të



huaja, energjia alternative etj. Përmes programit dhe platformës së tij qeverisëse, Hamza ka thënë se do të ketë më shumë mundësi për ndërmarrësi, vende pune me paga më të larta dhe më shumë shpresë dhe perspektivë për të rejtat dhe të rinjtë, që jetën e tyre ta ndërtojnë në vendin tonë, jo diku tjetër.



O'Brien takohet me Kurtin në Prishtinë, temë diskutimi Asociacioni

Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, është takuar të hënën në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Takimi është zhvilluar në zyrën e kryeministrit. Ata kanë biseduar për zhvillimet në vendin tonë, raportet Kosovë - ShBA dhe procesin e dialogut me Serbinë, veçanërisht për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

shprehur gatishmëri për gjetjen e zgjidhjeve për stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Vuçiqi, po ashtu, tha se shpreson që dinamika e dialogut dhe bashkëpunimi rajonal "të vazhdojnë me mbështetjen e ShBA-së dhe Bashkimit Evropian".

Sa i përket dialogut, O'Brien në një intervistë për transmetuesin publik serb të publikuar më 21 tetor tha se kërkon që të gjitha marrëveshjet e arritura të

respektohen. Ai tha se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është "hap i rëndësishëm", por kërkoi të bëhet përparim edhe para themelimit të Asociacionit. "Asociacioni është një hap i rëndësishëm. Është e rëndësishme të shënohet përparim edhe para formimit të Asociacionit. Është e rëndësishme që njerëzit të jetojnë normalisht, të regjistrohen martesat, fëmijët që lindin dhe në të gjitha këto të punojmë njëkohësisht. Obligimet

ekzistojnë që nga viti 2015, kur u nënshkrua [marrëveshja për Asociacionin]. Nuk mund t'ju ofroj një afat kohor, por më e rëndësishmja është që serbët të jetojnë sikurse qytetarët evropianë", tha O'Brien.

Që nga viti 2013 Kosova dhe Serbia janë pajtuar për themelimin e Asociacionit. Më 2015 është arritur edhe Marrëveshja mbi parimet për themelimin e këtij asociacioni. Por, marrëveshjet nuk janë zbatuar kurrë. Kosova ka shprehur drojën se një asociacion i tillë njetnik mund të ndikojë në funksionimin e shtetit. Së fundi, qeveria e Kurtit është përballur me kritika nga ShBA-ja dhe shtete të tjera perëndimore, pasi komuniteti ndërkombëtar i ka cilësuar disa veprime të ekzekutivit të Kosovës, përfshirë edhe mbylljen e disa institucioneve që funksiononin sipas sistemit të Serbisë - si veprime të njëanshme dhe të pakoordinuara. Qeveria ka thënë se veprimet e saj janë në kuadër të shtrirjes së sovranitetit dhe të sundimit të ligjit.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 TETOR - Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, është takuar të hënën në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në ndërtesën e ekzekutivit. Qeveria e Kosovës nuk ka dhënë hollësi deri në orët e vona rreth këtij takimi, por burimet thonë se një ndër temat ishte themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier e ka mirëpritur O'Brienin në vizitën e tij të parë në Kosovë, dhe ka thënë se

bashkë me të do të diskutojnë me zyrtarë të Kosovës për çështjet bilaterale dhe do ta ritheksojnë përkushtimin e Shteteve të Bashkuara për popullin e Kosovës.

Një ditë më parë në Beograd O'Brien është takuar me presidentin serb Aleksandar Vuçiq. Pas këtij takimi, lideri serb tha se takimi me zyrtarin amerikan u fokusua në "zgjidhjen politike në rajon, në situatën aktuale në Kosovë dhe forcimin e bashkëpunimit në shumë fusha". Sa i përket Kosovës, Vuçiqi tha se ka shprehur "shqetësim të thellë lidhur me sfidat me të cilat përballet çdo ditë popullata serbe", duke shtuar se ai ka

Mbillet një pemë në kujtim të ambasadores Tina Kaidanoë në oborrin e Ambasadës së ShBA-së

Në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është mbjell një pemë për nder të ambasadores së parë të ShBA-së në Kosovë, Tina Kaidanoë, e cila ka vdekur disa ditë më parë. "Sot iu bashkova ndihmëssekretarit të Shtetit O'Brien dhe komunitetit të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë në një ceremoni dedikimi dhe mbjelljeje peme në kujtim të

ambasadores Tina S. Kaidanow, ambasadores së parë të ShBA-së në Kosovë. Kjo pemë do të qëndrojë si simbol i trashëgimisë së saj, duke na kujtuar përkushtimin e saj të palëkundur në rrugëtimin e Kosovës drejt paqes, demokracisë dhe pavarësisë", thuhet në njoftimin e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë që citon fjalët e Hovenierit.

Në Prishtinë hapet panairi Agri-Rinew 2024

Prishtinë, 21 tetor - Ambasadori i Gjermanisë, Jorn Rohde dhe ministri i Bujqësisë, Faton Peci, hapën të hënën në Prishtinë panairin Agri-Rinew 2024, i

cili thekson rrugën e Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm përmes inovacionit në bujqësi dhe energjisë së rinovueshme. Ambasada e Gjermanisë ka

njoftuar se është shpallur një skemë e re granti gjermano-kosovar, që synon ta mbështesë rritjen rurale dhe t'i paraqesë teknikat moderne të bujqësisë me

udhëzime të ekspertëve. Panairi vazhdon edhe dy ditë të tjera, duke shfaqur mundësi emocionuese për të ardhmen e sektorit bujqësor të Kosovës.



Qeveria emëron komisione për vlerësimin e kandidatëve për dy pozita të larta drejtuese

PRISHTINË, 21 TETOR - Qeveria e Kosovës ka mbajtur një mbledhje elektronike gjatë së cilës ka emëruar komisionin Ad hoc për vlerësimin profesional për pranim në dy pozita të larta drejtuese. Këto pozita përfshijnë drejtorin e Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

dhe drejtorin ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Kështu është bërë me dije për medie të qeverisë. "Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një mbledhje elektronike, në të cilën ka emëruar komisionin Ad hoc për vlerësimin profesional për pranim për pozitën e lartë të

kategorisë drejtuese: drejtor i përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe komisionin Ad hoc për vlerësimin profesional për pranim për pozitën e lartë të kategorisë drejtuese: drejtor ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil", thuhet në njoftim.



Qyteti i Yonkersit në ShBA nderon Haradinajn

PRISHTINË, 21 TETOR - Në një ceremoni të veçantë në qytetin Yonkers të Nju-Jorkut, kryetari i qytetit, Mike Spano, e ka vlerësuar me Mirënjohjen e Qytetit dhe ka shpallur zyrtarisht datën 20 tetor 2024 si "Dita e Nderuar e Ramush Haradinajt, me motivacionin

'Për njohjen e shërbimit shumëvjeçar ndaj vendit të tij dhe përkushtimin e tij në përmirësimin e zhvillimit ekonomik dhe kulturor, si dhe në shërbimin publik'. "Gjithashtu në këtë ceremoni, kryetari Spano shpalli 20 tetorin 2024 si ditën zyrtare të ngritjes

së flamurit të Kosovës në qytetin e Yonkers. Ky nderim është një vlerësim jo vetëm për mua, por për të gjithë ata që besojnë në një Kosovë të lirë, të zhvilluar dhe të integruar në NATO, si dhe në miqësinë e palëkundur mes popullit tonë dhe atij amerikan. Ua dedikoj këtë mirënjohje

bashkëlufëtarëve të mi në radhët e UÇK-së dhe çdo ushtari amerikan që ka shërbyer në Kosovë. Ky çmim është dëshmi e përpjekjeve tona të përbashkëta për një Kosovë më të mirë dhe më të fortë. Zoti e bekoftë popullin e Kosovës! Zoti e bekoftë Amerikën! Zoti e

bekoftë miqësinë tonë të përjetshme!", ka njoftuar Haradinajn në "Facebook". Lideri i AAK-së po qëndron për vizitë në ShBA. Ai ka pasur takime të rëndësishme edhe me komunitetin shqiptaro-amerikan dhe zyrtarë të lartë të ShBA-së.



Konjufca takon drejtoreshën rajonale të UNFPA-s, diskutojnë për rritjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve

PRISHTINË, 21 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim drejtoreshën rajonale të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Justine Coulson. Konjufca e falënderoi Coulsonin për vizitën, teksa shprehu rëndësinë e bashkëpunimit të përpjekjeve për të avancuar gjithnjë e më shumë në garantimin e të drejtave universale në lidhje me shëndetin riprodhues, për

ta rritur mirëqenien sociale dhe për barazi, në aspektin gjinor si në shkallë më të gjerë. Po ashtu, ai e njoftoi me arritjet e Republikës së Kosovës në këtë drejtim, njëkohësisht i paraqiti synimet dhe angazhimin për arritje të tjera në vazhdim, duke përfshirë këtu edhe Ligjin për Shëndetin Riprodhues dhe përpjekjet për mekanizma sa më efikase të mirëqenies sociale. Bashkëbiseduesit u pajtuan

për nevojën e rritjes së mëtejme të bashkëpunimit, në mënyrë që të tejkalohen sa më lehtë dhe sa më shpejt sfidat që gjenden përpara. Drejtoresha Justine Coulson e falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen si dhe shprehu gatishmëri të plotë për bashkëpunim sa më të ngushtë në lidhje me çështjet e adresuara që prekin shëndetin dhe mirëqenien sociale të popullsisë së Republikës së Kosovës.



ÇKAPJA E SHTETIT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Arroganca primitive e pushtetit: Në zgjedhjet e shkurtit 2021 pati një dridhje tektonike të pushtetit paraprak prej mbi 50 për qind të votave të fituara nga koalicioni LV - GUXO dhe Alternativa. Albin Kurti u portretizua si Mesia që do ta shpëtojë popullin dhe Kosovën, Shqipërinë, Çamërinë dhe Maqedoninë, Malin e Zi dhe Luginën sikur edhe trojet tjera ku kishin jetuar pellazgët, ilirët, arvanitasit dhe të tjerët, me gjene shqiptare. Një shtet, një popull, një gjuhë dhe një flamur ishte karremit supermashtues i Albin Kurtit dhe shpurës mashtruese përcjellëse, pjesa dërrmuese që kishin dalë nga kotilla jugosllave dhe serbe. Kurti e donte UÇK-në për përfitime politike kurse i urrente themeluesit e Ushtrisë së Lavdishme Çlirimtare gjithashtu për përfitime politike. Bacë Adem Demaçin e ka respektuar për t'i hapur rrugë drejt majave të pushtetit, në çastin kur Baca nuk ka pranuar kushtin e Kurtit për ta rrëzuar Hashim Thaçin, si kusht për ta votuar për president, Albini është larguar dhe kurrë më nuk e ka përkrahur Bacën Adem për asgjë. Në fakt, Baca Adem është larguar nga Albini por se publikisht nuk ka folur asgjë keq për Kurtin ndonëse, po të donte mund ta çmontonte Albin Kurtin. Kur është shpallur pavarësia e Kosovës, Baca Adem ka kërkuar nga Albini dhe unë të shkojmë bashkë në Kuvendin e Kosovës. Albini e ka refuzuar sepse nuk do të mbijetonte situatën që në prani të tij Hashim Thaçi ta lexonte Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës duke u shndërruar në histori të gjallë të kombit dhe shtetit, si udhëheqës ushtarak dhe si lider politik. Unë e refuzova për faktin se thjesht u tregova budalla, doja të bëhesha më patriot se Baca Adem. Me mend nuk ka

mahi! Albin Kurti nuk ka lënë mjet pa përdorur për të ardhur në pushtet, tash nuk do të lë pa bërë gjë për të mbetur në pushtet. Prandaj ka bërë çmos t'i heq nga skena politike kontribuuesit më të mëdhenj të lirisë, themeluesit të shtetit dhe ata që e shpallën pavarësinë, me intriga dhe metoda që për kah efekti propagandistik Gebelsin e nxjerrin leshko dhe amator. Bashkëmin kombëtar, flamurin kombëtar, luftën kundër korrupsionit, nepotizmit, transparencën dhe llogaridhënien i kishte karta mashtruese në lojën me poker, së pari me votuesit e pastaj edhe me ndërkombëtarët. Çkapja e shtetit ishte qershizë mbi tortën që ua premtoi, urbi et orbi, kopesë politike shoqëruese dhe të tjerëve. Tingëllonte bukur për vesh, ishte shumë e pranueshme si përmbajtje aq më parë që vërtet duhej një ndryshim. Ishte i nevojshëm një ndryshim. Albin Kurti, Listën Serbe botërisht e përjashtoi nga qeverisja por jo edhe nga detyrimi kushtetues për t'iu ndarë postet që iu takojnë. Tash pritej të formoheshin institucionet dhe të mbusheshin me profesionistë, ekspertë dhe politikanë që premtimet e dhëna, t'i përkthenin në realitet. Dhe, që nga kjo pikë u pa se nuk ka asgjë nga përmbushja e premtimeve. Pse, do të pyesni, me të drejtë?!

Shkojmë radhazi: Kryetar i Kuvendit u zgjodh një demagog ambicioz, një "drveni filozof" apo përkthyer në shqip një Pinokio politik. Hundëgjatë, fjalëgjatë, i pavendosur për ndryshime dhe i vendosur të jetë servil permanent i padiskutueshëm i Kurtit. Kjo, edhe hahej disi sepse ky farë Pinokio kishte të kaluar të mirë familjare dhe kombëtare. Zgjedhja, në mënyrë krejtësisht korruptive, të pamoralshme dhe në kundërshtim me çdo standard minimal kombëtar të Vojsa Osmanit presidente e shpërfaqti patologjinë, thuaja sadiste të Kurtit të manipulojë me njerëz dhe fate duke i mbajtur peng me poste dhe të mira materiale. Vojsa Osmani digjet dhe

piqet për poste dhe të mira materiale dhe, në rrugën e realizimit të këtyre qëllimeve shkelë çdo parim njerëzor, moral dhe ligjor. Që të dy e sulmonin Listën Serbe kurse me dy vota klienteliste të LS-së dhe dashamirësinë dhe korrektësinë e partnerit të ardhshëm ilegal, Millan Radojiçiq u zgjodh presidente sikur që u kaluan shumë ligje apo u penguan nisma me interes kombëtar. Qeveria e Kosovës që u propozua nga Albin Kurti ishte qeveria më e dobët profesionalisht, më e korruptuar materialisht, më e degraduar moralisht dhe më e kompromituara kombëtarisht. Edhe qeveria e Xhingis Kanit ka qenë më patriotike se qeveria Kurti 2. Një herë tjetër do të shkruaj për çdo ministër të kësaj qeverie, veç e veç.

Çkapja, si mundësi për të kapur vet: Nuk ka segment në Kosovë që nuk është kapur apo që nuk është në kapje e sipër se që po ndodhë tani. Është kapur Kuvendi nga analfabetë që po e kryejnë kursin kundër analfabetizimit të analfabetja kombëtare dhe akademikja greke dhe serbe, Dejana Mihali. Është kapur presidenca nga soji dhe sorrollapi që janë shndërruar në rregëzinë të Kurtit. Edhe sot, Vojsa Osmani që Kurti e ka shndërruar në mazohiste, i shkakton dhimbje vetes duke duruar Kurtin për një tjetër mandat, hesht si shushunjë e Teneqe Muratit, sa për të mbijetuar. I mbanë zhagun Kurtit sidomos kundër pengjeve të Hagës, veteranëve të luftës, ish të burgosurve politikë dhe vlerave kombëtare. Nga pozita e një patriotizmi të rremë. Pasioni patologjik për pushtet e jo për shtet i ka shndërruar që të dy në pengje të atyre që vet i kanë liru nga kutia e Pandores ku i kishin futur si engjëj e tash të shndërruar në djaj. Vojsa Osmani është peng i Albin Kurtit, vullneti i Albinit është përcaktues për vazhdimin e jetës apo vdekjen politike të Vojsa Osmanit. Albin Kurti ia ka çrregulluar kartonin shëndetësor Vojsa Osmanit, vet ia hapë historinë, vet ia mbyllë historinë. Edhe nëse Vojsa Osmani sëmuret (larg qoftë) nga gripi, do të

detyrohet ta përdorë terapinë që ia cakton dr. mr. Albin Kurti e jo profesionisti i fushës.

Albin Kurti është peng i Dejana Mihalit, Mimoza Kusarit dhe mendjemadhësisë patologjike. Është peng i ministrave që ia dorëzoi buxhetin ta kullosin kur të duan, si të duan dhe kur të duan. Këta tani e shantazhojnë Kurtin e jo Kurti këta. Sepse, për çdo gjë gishtin e drejtojnë kah Albini. Po e shihni Mimoza Kusarin, e mbanë në grusht Albinin dhe ky ka frokë mos e hapë grushtin. E shihni këtë fredibelericen, Dejana Mihalit, Albin Kurti më shumë i ka frikën kësaj se Blerim Isufajt. Shumë gjerë e kanë lëshuar kosën, e kanë bërë m.t gjithandej.

Edhe një mandat kryeministër: Nuk e besoj ndonëse Kurti do të bëjë çmos për të mbijetuar. Do të bëjë lëshime për çdo gjë që i kërkohet, pavarësisht dëmit. E kundërshtoi pronën e Manastirit të Deçanit, vet e nënshkroi pastaj këtë. E kundërshtoi Zajebnicën, me Marrëveshjen e Brukselit dhe Ohrit po ua siguron autonominë territoriale dhe politike Zajebnicës. Nuk ka akt më të lartë tradhtie kombëtare, politike dhe shtetërore se kjo marrëveshje. Dhe shumë të tjera. Përkundër lëshimeve që i ka bërë dhe që do t'i bëjë, pa asnjë dyshim duke shpresuar dhe besuar edhe për një mandat, nuk e besoj se pas 9 shkurtit Albin Kurti do të jetë KM e as LV-ja, pjesë e qeverisë. Partitë parlamentare shqiptare do të jenë PDK, LDK, AAK-Nisma, Lidhja për Familjen sikur që do të jenë edhe minoritetet, Lista Serbe dhe partia multietnike, Vetëvendosje. Partitë shqiptare janë deklaruar se nuk bëhen bashkë me LV-në ndërkaq nuk e besoj se votat e partnerëve aktual qeverisës LV dhe LS do të jenë të mjaftueshme për të krijuar shumicën qeverisëse. Nuk besoj se ndërkombëtarët, siç mendon opozita naive, do të pengojnë që Albin Kurti të bëhet KM. Nuk mund të gjejnë njeri më të përshtatshëm dhe më të dëgjueshëm, e bënë një zhurmë mashtruese për opinion ama ua kryen të

gjitha punët. Si dikur Ahmet Zogu, Nikolla Pashiqit.

Dikush thotë se kam mllef ndaj Albin Kurtit. Aspak. Madje, zotohem publikisht se nëse Kurti, me veprime apo mosveprime, do të më demantojë këto që po i shkruaj, do të bëhem përkrahësi më i madh i tij! Pushteti e ka magjepsur Albin Kurtin, sikur Dylqinjen nga Toba të Don Kishotit. Mashtrimi ka një çmim që nuk paguhet kur je rehat, por kur të bëhet ngushtë. Shpërfillja e mbështetësve, patriotëve, njerëzve të mirë, duke përkrahur llaskuçët dhe ata me mungesë të kurrizit njerëzor dhe kombëtar, ka një çmim të caktuar, i faturohet Albinit. Shpërfillja dhe injorimi i gjakut të dëshmorëve, heronjve të luftës, qëndrestarëve të palëkundur, e ka një çmim. Përpjekja për manipulim dhe instrumentalizim të familjes Jashari, që ranë dëshmorë duke luftuar dhe duke kënduar, ka një çmim. Manipulimi me një pjesë të gjallë të familjes Jashari ka kuptim për ata që duan të manipulohen dhe ka të tillë. Shpërfillja dhe urrejtja patologjike ndaj atyre që e formuan UÇK-në, luftuan dhe e fituan lirinë, e shpallën pavarësinë dhe formuan shtetin, ka një çmim, duhet ta paguajë Albini sepse, si sadist i padiagnostikuar, i gëzohet faktit që janë në burgun e Hagës dhe si ateist i deklaruar i lutet Zotit që ata të mos dalin kurrë nga Burgu i Hagës. Prandaj duhet ta paguajë një çmim. Dhe, së fundi, shpërfillja e maskuar si përkrahje ndaj Bacës Adem Demaçi, është fatura më e rëndë dhe më e kushtueshme për Albin Kurtin. Baca Adem sigurisht do t'ia falte dhe nuk do të vepronte si Zeusi që shpërfillësit e tij i gurëzonte apo i shndërronte në kafshë, mirëpo Drejtësisë Hyjnore nuk ia falë në kohën kur drejtësinë tokësore e ka kapur sikur edhe Shtëpinë Publike për Prostitucion Informativ Legal apo RTK. Larg ka shkuar Albini. Vështirë ta gjejë rrugën e kthimit!

Fillon trajnimi i gjeneratës së 61 të Policisë së Kosovës

PRISHTINË, 21 TETOR - Policia e Kosovës, respektivisht Divizioni i Trajnimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ka filluar trajnimin themelor për gjeneratën e 61-të të kadeteve të Policisë së Kosovës, trajnim

nga i cili kadetët policorë do të përfitojnë njohuritë e nevojshme sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes të detyrave me profesionalizëm në shërbim të të gjithë qytetarëve. Kjo gjeneratë numëron gjithsej

467 kadetë, ku janë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Me këtë rast kadetët policorë janë pritur dhe u është dëshiruar mirëseardhje nga eprorë të PK-së, përfaqësues të Divizionit të Trajnimeve.



AGK-ja themelon Rrjetin e Grave Gazetare të Kosovës



PRISHTINË, 21 TETOR - Në bashkëpunim me 25 kolege gazetare e të organizatave ndërkombëtare, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, pas identifikimit të nevojave, shqetësimeve e kërkesave të gazetareve, në fundjavë vuri themelet e Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës.

Koleget e pranishme propozuan dhe votuan Bordin Këshillëdhënës të këtij Rrjeti, i cili ka në përbërje tri super gra të dëshmuara në gazetari si: Leonida Molliqaj - redaktore në QIKA, Gentiana Begolli Pustina - udhëheqëse e Departamentit për Komunikim dhe Marrëdhënie

Ndërkombëtare në RTK, si dhe gazetaren nga Klan Kosova, Qëndresa Tërshani.

Masha Mileusniq e ndau përvojën e saj si mentore e themelueseve të këtij rrjeti ku foli më gjerësisht për rëndësinë dhe praktikën më të mira të funksionimit të rrjeteve të grave gazetare.

Misioni i këtij Rrjeti është krijimi i një ambienti gjithëpërfshirës për gratë që punojnë në medie, parandalimin e përdorimit të gjuhës seksiste dhe mizogjene në diskurs publik, si dhe krijimin e një hapësirë të sigurt për adresimin e problemeve që hasin në vendin e punës apo gjatë punës në terren.

Rrjeti është i hapur për anëtarësim të secilës grua që punon në sektorin media. Inkurajohen të gjithë koleget që të anëtarësohen në këtë Rrjet, në mënyrë që të kontribuojnë sa më shumë në përmirësimin e pozitës së gruas në vendet e punës, por edhe në diskursin publik. "I falënderojmë përzemërsisht për kontributin e dhënë koleget e pranishme në këtë takim të parë të këtij Rrjeti, si dhe për mbështetjen e padiskutueshme të dhënë nga British Council Kosovo, NDI Kosovo, OSCE Mission in Kosovo dhe European Union in Kosovo", thuhet në njoftimin e AGK-së.

Fillon edicioni i 10 i Shkollës Diplomatike për diplomatë të rinj

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 TETOR - Në qytetin e Pejës është bërë hapja solemne e edicionit të 10 të Shkollës Diplomatike për diplomatë të rinj. Për pesë ditë, nga 21 deri më 25 tetor, në gjithsej 13 sesione të ndryshme përgjatë javës, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të ndjekin panele të diskutimit me ekspertë të fushës, përfaqësues të lartë të qeverisë, profesorë universitarë dhe përfaqësues diplomatikë në kuadër të temës qendrore të edicionit të sivjetmë "Roli për humanizimin: vitaliteti i përpjekjeve diplomatike për përbalimin e krizave".

Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në hapjen e këtij edicioni. Duke u urrear pjesëmarrësve sesione të suksesshme dhe përvojë të pasur në Kosovë, ai tha se më shumë se shtetet e tjera, Kosova është një vend që

mbështetet thellësisht në diplomaci. "Nga Madeleine Albright te Martti Ahtisaari, arritjet tona kanë qenë kryesisht sukses i diplomacisë, të mbështetur nga diplomacia e fortë (hard power) dhe diplomacia e butë (soft power). Si një vend që ka përfituar shumë nga diplomacia ndërkombëtare, ne besojmë fuqishëm se është detyra jona të investojmë në trajnimin e diplomatëve të mëdhenj jo vetëm për ta nxitur përparimin tonë shumë të nevojshëm por, gjithashtu, për të kontribuar dhe shpëguar botën. Shkolla Diplomatike e cila tani po feston 10-vjetorin e saj është një nga mënyrat sesi po e bëjmë këtë", u shpreh kryeministri.

Ai tha se që një diplomaci të jetë e suksesshme, kërkohet zotërim i mirë i historisë së rajonit, të kuptuarit e kulturës së njerëzve apo popullit dhe konsideratë ndaj ekonomisë së vendit. "Ta zotërosh historinë do të thotë të



jesh në gjendje të mendosh në kontekstin e kohës dhe të gesh përgjigje për pyetjet aktuale, sepse shumë nga sfidat e tanishme nuk janë vërtet të reja. Ato vijnë nga një sfond historik që na paraqitet në formë tjetër, por të rrënjësuar në histori, të ushqyer nga kultura dhe të kushtëzuar nga ekonomia. Nuk

është ekzagjerim të thuhet se e ardhmja e njerëzimit do të varet nga diplomatë të rinj si ju", u shpreh kryeministri Kurti teksa iu drejtua pjesëmarrësve të edicionit të 10 të Shkollës Diplomatike, të cilëve u uroi diskutime produktive dhe qëndrim të këndshëm në Kosovë, me shpresën që me

shumë prej tyre do të mund të takohet përsëri në të ardhmen në angazhimet e tyre diplomatike. Krahas kryeministrit, fjalim mirëseardhës pati edhe zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e cila theksoi se prania sot, pikërisht në Kosovë, e pjesëmarrësve nga 30 vende të ndryshme, nënvizon besimin tonë të përbashkët për rolin qendësor të diplomacisë. Ajo shtoi se Republika e Kosovës është një shtet me qëndrime të forta të bazuara në vlera, ku 90 % e qytetarëve tanë mbështesin integrimin në BE dhe NATO, dhe kjo pasqyron përkushtimin tonë të palëkundur ndaj demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Edicioni i 10 jubilar i Shkollës Diplomatike për diplomatë të rinj organizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në bashkëpunim me Fondacionin "Friedrich Ebert".

KEDS-i u bënë thirrje studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme të aplikojnë në KEDS Academy XII

PRISHTINË, 21 TETOR - KEDS-i vazhdon të ofrojë mundësi unike për nxënës dhe studentë që të përgatiten për tregun e punës dhe eventualisht të punësohen në kompani. Ata nga 21 tetor deri më 8 nëntor 2024 mund të aplikojnë të bëhen pjesë e KEDS Academy XII. Mundësi aplikimi kanë të gjithë studentët që janë duke

ndjekur studimet në vitin e fundit akademik në Fakultetin Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike - Drejtimi Elektroenergetikë, dhe ata në Fakultetin e Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstrukione dhe Gjeodezi, si dhe nxënësit e klasës XII të Shkollave të Mesme Profesionale Eelktroteknike - Drejtimi Energetikë dhe Instalues

Elektrikë. Kjo është Gjenerata XII e KEDS Academy në të cilën studentët e nxënësit e përzgjedhur do të kenë rast e mundësi të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional, që do t'u shërbejë më lehtë në tregun e punës. Deri më tash nëpër këtë program të KEDS Academy janë trajnuar rreth

700 studentë dhe nxënës përgjatë njëmbëdhjetë vjetëve që kur ky program për këtë kategori ka filluar të zhvillohet në ambientet e KEDS-it. Vlen të përmendet se një pjesë e konsiderueshme e tyre tashmë janë pjesë e kompanisë, disa prej tyre edhe në pozita menaxheriale. KEDS Academy është program kryesor në Kosovë në fushën e



Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave (CSR) sa i përket sektorit të edukimit.

Dick Marty, ky mashtrues i madh



**Prof. dr. Agim
ZOGAJ**

Historia e një trillimi

Po bëhen katër vjet nga arrestimi dhe mbajtja në paraburgim e disa nga krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndryshe, udhëheqës të lartë të shtetit të Kosovës. Bazë për ngritjen e aktakuzës kundër tyre ishte raporti i Dick Martyt, i cili raport. në fakt ishte një sajësë politike, trillim i paskrupullt në bashkëpunim me shtetin e Serbisë, Rusinë dhe ndonjë aleatë të tyre, të hapur dhe fshehtë, pra, edhe në Këshillin e Evropës. Jo më shumë se tre javë, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ish-prokurorja e përgjithshme në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, Carla Del Ponte e kishte dhënë një intervistë për Swissinfo. Në intervistën e botuar më 11 mars 2008, Del Ponte, ngjashëm, sikur propaganda serbe dhe ajo ruse e kundërshtonte legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ndërkohë, një ditë pas publikimit të intervistës së Carla Del Ponte, kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të Këshillit të Konfederatës Helvetike, Dick Marty, në intervistën me gazetaren, Silvia Cattori, të publikuar më 12 mars 2008, ngjashëm sikur Del Ponte, në të njëjtin pozicion me shtetin serb dhe rus, kishte kundërshtuar shpalljen e pavarësisë së Kosovës gjoja, "...në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare". Në të njëjtën intervistë, Dick Marty, akuzon, përballt, me të njëjtën gjuhë shoviniste të shtetit serb, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, madje, duke e cilësuar edhe si "...organizatë kriminale... që u shndërrua në instrument të amerikanëve për t'u mundësuar atyre në Kosovë krijimin dhe mbajtjen e bazës

ushtarake më të madhe në botë"!?

Carla Del Ponte, në detyrën e prokurores së përgjithshme në Gjykatën Penale të Hagës, gjithnjë nën presionin me vetvullnet, udhëzimin e propagandës serbe dhe ruse, kishte urdhëruar zhvillimin e hetimeve lidhur me pretendimet e shtetit serb për gjoja "trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja".

Pas përfundimit të hetimeve të zhvilluara, po e njëjta Del Ponte kishte urdhëruar mbylljen, përfundimin e atij hetimi, asaj çështjeje duke e kualifikuar propagandën serbe si "...legjendë e thjeshtë e sajuar njëllor si tregimet e ngjashme që shfaqen në zonat e tjera të konflikteve"! Ndërkohë, çështjen e sipërpërmendur, krejt papritur e kishte aktualizuar në librin e saj "Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës".

Aso kohe, ishte më se e qartë se, kjo lloj gjuajtje në shtriga, me metodat më të sofistikuar në radhë të parë, të shërbimeve sekrete serbe dhe ruse, do të hap një kapitull të luftës special, kundër pavarësisë së Kosovës, kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe natyrisht, shtizat e sulmeve me helm in e propagandës serbe do të bien mbi krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mbi ata, të cilët në planin ushtarak dhe diplomatik krijuan aleancën me NATO-n, me qytetërimin euro-perëndimor. Me një shpejtësi rrufeje, Serbia, agresori historik i shqiptarëve, që më 15 prill 2008 avancoi në propagandën e saj kundër Kosovës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kësaj radhe, përmes deputetit rus në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Konstantin Kosachev i cili, më 15 prill 2008 e dorëzoi propozimin për Rezolutë lidhur me "trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtisë ilegale me organet e njerëzve"?

Projekt-rezoluta ishte nënshkruar nga 17 deputetë, duke u mbështetur me atë rast vetëm në thëniet spekulative, hakmarrëse, të Carla Del Pontes, pra, marrë nga libri i saj. Një ditë pas nënshkrimit të asaj Projekt-rezolute, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, mbajtur

më 14 - 18 prill 2008, delegacioni parlamentar zviceran dh ai suedez propozuan që të hapet debat lidhur me "pasojat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës". Gjatë atij debati, pikërisht më 16 prill 2008 diskutimi i Dick Martyt, për shumëçka ishte i veçantë, jashtëzakonisht ekstrem dhe i trilluar.

Bashkëpunimi i shtetit serb me Dick Martyt

Dick Marty, nuk kurseu fjalor politik, policor, hetues, anatomues, deskriditues, ngjashëm, sikur qeveritarët serbë kundër Kosovës. Madje, po të analizohej, atëherë dhe sot fjala e tij, kuptohet se, cili ishte objektivi i planit serbo - rus, i përquar dhe transmetuar në mbarë botën, aq brutalisht siç e ka paraqitur Dick Marty. Logjika politike, e propagandës spekulative të cilën në fjalën e vetë e kishte paraqitur Dick Marty, është në unison të plotë me propagandën, historikisht të njohur serbe, kundër shqiptarëve dhe veçmas kundër Kosovës. Dick Marty kishte konstatuar se : "...pas dhjetë vjetësh të administrimit ndërkombëtar, Kosova gjendet pa një shoqëri të mirëfilltë civile. Të gjithë ata që preokupohen me çështjen e kriminalitetit, e dinë se Kosova ka qenë gjithmonë e ndoshta sot më shumë se dje, një qendër e kriminalitetit ndërkombëtar e kriminit të organizuar (...)"? Dick Marty, pra, edhe para hartimit të raportit të tij famëkeq, e qartëson pozicionin e tij pro serb e pro rus, duke i shpallë luftë të ndytë Kosovës, duke e etiketuar si "oazë" historike të "kriminit" të organizuar. Por, Dick Marty, i gjetur me vetëvullnet, në kurthet e propagandës serbo/ruse, harron se, Kosova që nga viti 1912 e deri në vitin 1999 ishte tokë e pushtuar na Serbia/Jugosllavia, ndaj, si ka mundur të ishte "qendër e kriminalitetit ndërkombëtar" kur nuk është vetëadministruar!?

Propaganda serbe në kombinim me atë ruse, dhe e transmetua nëpër botë, përmes Carla Del Pontes dhe sidomos nga Dick Marty, krijoi një

konfuzion të pa parë në opinionin e atëherëshëm euro-perëndimor. Si rrjedhojë, pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe të argumentuar, të mbështetur në burime, fakte, dëshmi, Komisioni për Çështje Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës më 16 prill 2008 e kishte ngarkuar, pikërisht Dick Martyt të hartonte një raport për çështjet të cilat, me skenarin e propagandës serbo-ruse tani më ishin bërë publike. Publiku euro-perëndimor, ishte tronditur me të thënat, deklaratat, e Dick Martyt, veçmas me pretendimet e tij se, gjoja çlirimtarët e Kosovës kanë ndërmarrë veprime për trafikim të organeve të personave të vrarë!?

Publiku euro-perëndimor, nuk mund ta kishte as idenë më elementare se, një euro-parlamentar si Dick Marty, qëllimisht bëhet zëdhënës, i propagandës primitive, shoviniste, jociivilizuese të shtetit serb dhe atij rus! Shqiptarët ndërsa, të gjetur në huti nga ajo propagandë gebelsiane, krejtësisht e pamoralshme nga një euro-deputet, i një shteti model të qytetërimin dhe edukatës politike e qytetare, nuk e kishin marrë me shqetësim, nuk kishin reaguar ndaj shpejtësive të Dick Martyt. Kjo mosvigjilencë e institucioneve, sidomos të drejtësisë të Kosovës, do të kishte pasoja fatale.

Ndërkohë që, e tronditur dhe e revoltuar nga ai manipulim politik i çështjes, aq të ndjeshme, pra, edhe nga përfshirja e pashembullt e Carla del Pontes, në përhapjen e paskrupullt të propagandës serbe/ruse. Kishte reaguar Florence Hartmann, ish zëdhënësja e prokurorisë së përgjithshme. Ajo kishte reaguar përmes një shkrimi të botuar në gazetën "Le Temps", datë 16 prill 2008.

Në shkrimin me titull, "Carla Del Ponte dhe thashethemet për trafikim me organet në Kosovë", shkruante se: "...si është e mundur që Carla Del Ponte, puna e së cilës konsistonte që të kërkohet e vërteta, përkundër pengesave, dhe në këtë mënyrë të luftohet mohimi dhe manipulimi, sot të na fundos në kohën më të errët

të propagandës...Të flitet sot, përderisa për pesë vjet nuk u soll asnjë element i ri që do ta mbështeste këtë tezë, është papërgjegjësi"!

Është e dokumentuar, shteti serb, përmes shërbimit të tij të inteligjencës, ishte i vendosur që ta instrumentalizonin Dick Martyt, ndaj, shumë shpejt i vunë kontaktet me të dhe e bënë viktimë, me dashje të kurthit të tyre. Ishte shans i jashtëzakonshëm për shtetin e Serbisë, Rusisë dhe aleatët e tyre që, në mënyrë të paskrupullt, plot helm dhe vrer politik ta manipulojnë opinionin publik euro-perëndimor dhe atë botëror. Ish ambasadori serb në Zvicër, Milan St. Protiç pikërisht në përrurimin e librit të tij, më 24 tetor 2018 e kishte bërë publike se, drejtpërdrejt, ai vetë, në prani edhe të zyrtarëve të shtetit serb, ia kishte dhënë Dick Martyt "...provat e përgatitura nga institucionet e Serbisë për trafikimin e organeve dhe për Shtëpinë e Verdhe"! Ai, ishte ndjerë krenar dhe ishte lavdëruar duke propaganduar se, ishte personi kryesor i cili ndikoi që të themelohet Gjykata Speciale. Hapur e kishte pranuar se, në disa takime, radhazi, ku kishte marrë pjesë edhe Kryeprokurori serb dhe agjentët e BIA-së, kishte arritur që, Dick Martyt ta bindte për ta hartuar raportin për krimet e pretenduara të shqiptarëve.

Gënjeshttrat, spekulimet tronditëse në raportin e Martyt

Ndoshta, as vetë Dick Marty, nuk kishte besuar në fabrikimin morbid të dhënave të rrejshme të Shërbimit sekret serb, në lidhje me gjoja "trafikimin e organeve" të personave të vrarë, dhe me ekzistimin e të ashtuquajturës Shtëpi e Verdhe. Dick Marty, gjatë bashkëpunimit me zyrtarët serbë, pra, edhe me Shërbimin e tyre sekret, duket se ka qenë tepër naiv për të besuar në "përrallat e frikshme" serbe, ose, qëllimisht, si një kundërshtar i pavarësisë së Kosovës dhe antiamerikan i përбетuar, ka besuar se, me Raportin e shpifur do të jetë në shërbim të planeve serbe. Edhe

në fazën e hetimeve, vazhdimisht sekrete dhe në bashkëpunim me Shërbimin sekret serb (BIA), edhe përmes gazetarëve "hulumtues" serbë, në lidhje me pretendimin e trafikimit të organeve, Marty nuk kishte gjetur asnjë provë! Këtë ia kishin bërë të ditur edhe ekspertët e EULEX-it për krime lufte, madje, duke ia qartësuar se akuzat për trafikim të organeve janë vetëm "përrallë e frikshme". Sa më tepër që zhvilloheshin hetimet, Dick Marty, pra, edhe në lidhje me Shtëpinë e Verdhë në Veri të Shqipërisë, nuk gjente prova. Ai fakt, Dick Martyn dhe bashkëpunëtorët e tij serbë, po i bënte jashtëzakonisht të frustruar. Sidoqoftë, nën tryshinë e qëllimit të tij makabër, kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftës çlirimtare të popullit të Kosovës, ndonëse pa asnjë provë, mashtruesi dhe keqbërësi, Dick Marty në Raportin e tij famëkeq, krejtësisht të trilluar, shkruan paragrafë për "heqjen e organeve me qëllim të trafikimit..."? Është për t'u veçuar fakti se pikërisht më 12 dhjetor 2010, raportuesi Dick Marty, pjesë e grupit të deputetëve liberal - demokratë

në Asambenë Parlamentare e dorëzoi dokumentin, po me të njëjtin titull sikur rusi, Konstantin Kosachev, "Trajtimi jo human i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovës"!

Dick Marty në Raportin e tij politik të Këshillit të Evropës ndër të tjera shkruan se: "...ndaj të ndaluarve në disa lokacione të Shqipërisë janë hequr në mënyrë të kundërligjshme organet e të cilat pastaj janë trafikuar për transplantim në vendet e treta..."? Por, tani, katër vjet pas ngritjes së aktakuzës së Gjykatës Speciale kundër disa, prej krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në asnjë paragrafë të aktakuzave përkatëse nuk flitet për trafikim të organeve dhe as për Shtëpinë e Verdhë. Dyshimet për trafikim të organeve nuk u provuan asnjëherë. Këtë e kishte deklaruar edhe ish prokurori Clint Williamson i cili, përmes Task Forcës Speciale Hetimore të BE-së ishte marrë me hetimin e raportit të Dick Martyt.

Ish-prokurori i Tribunalit të Hagës dhe avokati, Geoffrey Nice, ndërsa në një prononcim për mediet në Kosovë ka thënë

se: "...Si një vështrues i jashtëm mendoj se ka ardhur koha për prokurorin e kësaj gjykate z. Smith që të njohë dëmin të cilin i ka bërë popullit tuaj dhe të dalë qartazi dhe të thotë se ne nuk kemi dëshmi të tilla dhe se askush nuk do të akuzohet për këtë krim...Kur jam njoftuar për dyshimet për marrje organesh nga një revistë e cila shkruante për një raport dhe për një dëshmitar të cilit Serbia i referohej, si K 144, mu ka dukur plotësisht një shkrim i shpifur"!

Historia e fushatës së tërbuar dhe e shpifjeve, sipas skenarit serb, e Dick Martyt vazhdon dhe me rastin e Medicusit, një nga rastet më të gjata dhe më të përfolura në historinë ligjore të Kosovës së pas luftës. Duke iu referuar Raportit të shpifur të Dick Martyt, Rezoluta e Këshillit të Evropës në paragrafin e pestë shkruan se: "...ky aktivitet kriminal (trafikimi i organeve)...ka vazhduar deri më sot, siç tregohet nga një hetim që po e kryen...EULEX-I në lidhje me klinikën Medicus në Prishtinë". Pika e përmendur zë vend në paragrafin 168 të raportit të miratuar nga Këshilli i Evropës në të cilin thuhet se trafikimi i organeve i identifikuar në



raport është i lidhur ngushtë me çështjen e Klinikës Medicus.

Gjyqi i rastit Medicus ka filluar në tetor të vitit 2011 dhe ka vazhduar për 19 muaj pra, deri më 23 prill 2013. Gjyqtari ndërkombëtar, Dean B. Pinels në dëshminë e tij ndër të tjera deklaroi se: "Gjatë rrjedhës së gjyqit, ne e konsideruam me rëndësi jetike marrjen e dëshmisë së Dick Martyt pasi ai pretendoi se kishte prova përkatëse siç u përmenden më lart. Më pas ne bëmë një kërkesë zyrtare përmes kanaleve diplomatike në Këshillin e Evropës për pjesëmarrjen e tij në gjyq dhe, natyrisht, supozuam se ai dhe Këshilli i Evropës do të bien në dakord lehtë". Mirëpo, gjithnjë, sipas dëshmitarit të sipërpërmendur "Për tronditjen dhe habinë tonë, Marty dhe Këshilli i Evropës pretenduan se ai nuk ishte i disponueshëm me arsyetimin se kishte imunitet për të dëshmuar. Sipas mendimit tonë, ky pretendim ishte absolutisht i pakuptimtë sipas rregullave të Këshillit të Evropës, të cilat parashikojnë një përjashtim në raste të rëndësishme, por ne kurrë nuk arritëm ta siguronim pjesëmarrjen e tij në gjyq ose të

mësonim arsyen e vërtetë të refuzimit të tij..."?!

A do të thotë kjo se, Aktakuzat, të cilat u ngritën me falsifikime të "dëshmive" të rreme, të trilluara, ashtu siç ishte skenari serbo-rus duhet të rrëzohen, nga vetë Gjykata Speciale? A mban përgjegjësi dhe a duhet, edhe pas vdekjes së tij, të ketë ndjekje penale ndaj mashtruesit, Dick Marty, i cili, në rast se e konsideron veten se, ka rol në themelimin e Gjykatës Speciale atëherë është njoollorur dhe ishte person i dyshuar edhe me faktin që ka refuzuar të dëshmojë në procesin gjyqësor, të rastit Medicus? Më pastaj, historia e kësaj Gjykate Speciale dhe e aktakuzave kundër krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do ta jep verdiktin edhe për përgjegjësinë të cilën e mban Këshilli i Evropës? Dhe, mbi të gjitha, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të kërkojnë, në gjykatat ndërkombëtare, ndjekje penale ndaj institucioneve të drejtësisë të shtetit të Serbisë, për fabrikimin, përhapjen e të gjitha atyre gjoja "dëshmive", "provave" të inskenuara të cilat quan, në themelimin e Gjykatës Speciale dhe në ngritjen e aktakuzave kundër çlirimtarëve, ish-krerëve të pafajshëm, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Jordan Johnson, MVP i javës së gjashtë

PRISHTINË, 21 TETOR - Java e gjashtë e Pro Credit Superligës ishte shumë interesante me katër ndeshjet e zhvilluara, pasi secila ishte më e rëndësishme se tjetra. Fitore shumë të rëndësishme shënoi Proton Cable Prizreni ndaj Borës. Te prizrenasit më i miri ishte Jordan

Johnson, duke pasur indeksin 30, për ta mbyllur ndeshjen me 21 pikë, tri kërcime dhe 14 asistime. Johnsoni është një nga lojtarët më të dalluar te prizrenasit në këtë edicion. Fitore mjaft të rëndësishme shënoi edhe Golden Eagle Ylli ndaj Vëllaznimit, ku te therandasit më

i miri ishte Lis Shoshi. Ai për 30 minuta në parket kishte 18 pikë, 12 kërcime dhe një asistim. Trepça me rikthim fitoi ndaj Pejës, ku te mitrovicasit më i miri ishte Mouhamed Barro me 14 pikë, 11 kërcime dhe katër asistime. Bashkimi vazhdon të jetë skuadra e vetme pa humbje.

Prizrenasit në një super atmosferë fituan ndaj Sigal Prishtinës, ku shumë basketbollistë kontribuan për këtë fitore. Lejson Zeqiri e mbylli ndeshjen me 18 pikë, katër kërcime dhe një asistim, ndërsa Meriton Ismaili me 17 pikë, një kërcim dhe një asistim.



Urim Zenelajt i ndalohet basketbolli pas problemeve me zemër

PRIZREN, 21 TETOR - Basketbollisti i Pronto Cable Prizrenit, Urim Zenelaj, do të jetë jashtë fushave të lojës për disa muaj pasi ai ka shfaqur probleme me frymëmarrje në disa prej ndeshjeve të fundit dhe tashmë me rekomandimin e kardiologut, ai do ta ndërpresë aktivitetin sportiv.

Trajneri i KB Prizrenit, Arbnor Rifati, ka thënë për "KosovaPress" se gjatë javës pritet të bëhen ekzaminimet më të thella për ta kuptuar më mirë gjendjen shëndetësore të basketbollistit. "Urimi ka pasur shqetësime në disa ndeshjet e fundit me frymëmarrje dhe kishte ankesa kështu që sigurisht ne morëm hapat bashkë me atë një iniciativë për një kontroll të thellë dhe gjatë



vizitës së tij të cilën e ka pasur ditën e premte. Me udhëzim të një kardiologu të njohur i është rekomanduar ndalesa e të gjitha aktiviteteve sportive për disa

shkaqe kardiologjike dhe sigurisht që gjatë javës, nga nesër do të fillojnë edhe ekzaminimet më të thella", ka thënë fillimisht Rifati. Ai ka shtuar se Zenelaj për

momentin është në gjendje stabile shëndetësore dhe se shpreson që nga analizat që do të bëhen, të mos dalë diçka serioze. "Një gjë që e dimë deri më tani është që ai për një periudhë disamujore do të jetë jashtë fushës... Për momentin gjendjen shëndetësore e ka të mirë. Një fakt që na gëzon. Nuk ka ndonjë ankesë. Brenda javës duket se do të bëhet një koronografi që do të shikohet çdo detaj i mundshëm që mund ta ketë Urimi, kështu që ne lutemi dhe shpresojmë që mos të dalë ajo më e keqja dhe që në periudhën sa më të shpejtë të rikthehet aty ku e ka vendin", ka deklaruar Rifati. Në aspektin sportiv, Rifati thotë se mungesa e Zenelajt do të jetë hendikep i madh për KB Prizrenin. "Dëmi është shumë i madh. Në të

premtën kur morëm këtë lajm, normalisht brenga e parë ishte ana shëndetësore, që është prioritet para çdo aktiviteti sportiv, mirëpo në anën tjetër edhe për skuadrën tonë është një hendikep i madh pasi që tani shtatë vjet jemi pjesë e Superligës. Skuadra e Prizreni çdoherë e ka ndërtuar ekipin duke u bazuar në skeletin dhe bazamentin që e kishte Urimi si lojtar vendor dhe këtë e kemi bërë edhe këtë vit", ka përfunduar Rifati. Zenelaj është një ndër basketbollistët më të mirë në Kosovës. Ai ka luajtur për klubet më të mëdha të Kosovës, duke përfshirë Bashkimin, Sigal Prishtinën, ndërsa ka luajtur edhe për Kombëtaren e Kosovës në basketboll.

Sadriu rrëmben çmimin 'Ylli i javës'

FERIZAJ, 21 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e nëntë i ka takuar futbollistit të FC Ferizaj, Edon Sadriu. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, i përbërë nga Sunaj Keqi, Milaim Humolli dhe Edmond Cana. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e nëntë t'i jepet Sadriut, i cili për 84 minuta ishte lojtari më i dobishëm i skuadrës së tij. Ai shënoi golin që zhbllkoi rezultatin në Gjilan për fitoren e rëndësishme të FC Ferizaj kundër SC Gjilani (1:2). "Ndeshja me Gjilanin ka qenë shumë e mirë falë stafit të trajnerëve, i cili e ka analizuar shumë mirë lojën e kundërshtarit. Gjatë javës gjithçka që kemi punuar e kemi paraqitur në fushë ndaj një skuadre të mirë si Gjilani. Atmosfera në klub është shumë e mirë, ndonëse para disa javësh nuk ka qenë gjithmonë pozitive, pasi



na mungonin rezultatet. Por unë, si kapiten, së bashku me stafin e trajnerëve, kemi mbajtur ekipin e bashkuar dhe kemi arritur të kalojmë këtë krizë duke siguruar dy fitore radhazi. Shpresoj të vazhdojmë kështu. I falënderoj bashkëlojtarët për këtë çmim dhe besoj se çdo lojtar i FC Ferizaj do të ishte merituar për të fituar këtë çmim", ka thënë Sadriu për faqen zyrtare të FFK-së.

Muriqi: Jam i lumtur për golin dhe fitoren

MALLORCA, 21 TETOR - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi, është i lumtur me golin e shënuar dhe fitoren ndaj Rayo Vallecanos. Sulmuesi "dardan" realizoi golin e fitores në ndeshjen e parë pas rikthimit nga lëndimi që e mbajti një muaj jashtë fushës. "Jam shumë i lumtur që u ktheva pas lëndimit me gol dhe fituam para tifozëve tanë. Është ndjenjë shumë e mirë. Kam punuar shumë për këtë. Kisha disa mundësi të cilat duhej t'i shfrytëzoja më herët dhe jo të prisja deri në çastet e fundit, por ky është futboll. Duhet të punoj fort në javët e ardhshme për t'u përmirësuar", ka thënë Muriqi. Mallorca është në formë të jashtëzakonshme. Ishte fitorja e dytë radhazi për të, ndërsa e katërta në pesë ndeshjet e fundit. Muriqi deklaroi se është me fat për formën, ndërsa nuk pranoi të flasë kaq herët për një kualifikim në garat evropiane. "Jam me fat që shënoj pothuajse



në çdo ndeshje dhe më vjen keq për kundërshtarët, por kjo është puna ime. Ende është herët të flasim për garat evropiane. Dua t'i falënderoj tifozët sepse janë të mrekullueshëm, pavarësisht a fitojmë apo humbim. E ndiejmë vazhdimisht përkrahjen e tyre", ka deklaruar Muriqi. Mallorca aktualisht renditet në pozitën e gjashtë në La Liga me 17 pikë të mbledhura.

Shaqiri: Po përshtatem, dua t'i ndihmoj Baselit

BASEL, 21 TETOR - Deri më tani në sezonin 2024-2025, Xherdan Shaqiri ka luajtur në gjashtë ndeshje me Baselin. Në një intervistë të dhënë së

fundmi, lojtari me origjinë shqiptare u shpreh se po përshtatet shumë mirë me grupin. "Po lëviz shumë më mirë, ndeshje pas ndeshjeje.

Kjo është mënyra më e mirë për mua që ta ndihmoj ekipin", ka thënë ai. 33-vjeçari nuk ka realizuar gol ende në këtë edicion në kampionatin

zvicëran, por ka dhuruar një asistim. Kujtojmë që lojtari vjen pas një periudhe ku luajti te Chicago Fire në MLS amerikane.



NBA, gati ta ngrejë siparin

BOSTON, 21 TETOR - Mëngjesin e së mërkurës do të nisë sezoni 2024-2025 në NBA, kampionati më i bukur i basketbollit në botë. Ndeshja që do ta çelë sezonin e ri është ajo mes Boston e New Yorkut, që do të pasohet nga sfida mes

lakersave dhe Minnesotas. Një kampionat që pritet me shumë interes, me shumë yje që synojnë ta fitojnë titullin kampion dhe ta rrëzojnë nga fronti Boston Celticsin. Do të jenë pikërisht kampionët ata që do të zbrisin të parët në fushë.

Në një ceremoni, kampionët e sezonit të fundit do t'i marrin unazat e titullit, në një festë para tifozëve të tyre. Këtë sezon për herë të parë në historinë e NBA-s do të luajnë në një ekip babë e bir: Le Bron James e djali i tij Bronny me fanellën e

lakersave. Skuadra që ka ndryshuar më shumë këtë sezon është Philadelphia, që ka në përbërjen e saj plot tetë lojtarë të rinj. Të gjitha ekipet janë duke bërë përgatitjet e fundit në prag të sezonit të ri që pritet të dhurojë spektakël.



Uzuni: Dua ta shkruaj historinë te Granada

GRANADA, 21 TETOR - Me dy golat ndaj Tenerifes, Myrto Uzuni kaloi një rival dhe i mbetet edhe një shkallë për t'u ngjitur në podium, për të qenë shënuesi më i mirë në historinë e Granadës. Ylli kuqezi ka tani 39 gola, ndërsa në vend të parë është Jusef El Arabi me 44 gola. Uzuni la pas sulmuesin Odion Igallo, që goditi saktë 38 herë për këtë ekip. "Është e qartë se kam shumë respekt për Igalon, për historinë që ka lënë këtu në Granadë. Unë dua gjithmonë që të punoj fort dhe të shënoj, dhe që t'i kaloj të gjitha rekordet te Granada. Dua të jem më i mirë në historinë e Granadës jo për ta kaluar Igalon, sepse unë e respektoj shumë atë, por unë jam Myrto Uzuni dhe dua gjithmonë që ta shkruaj historinë edhe në Granada, ku ndihem si në shtëpi", ka thënë sulmuesi shqiptar.

Uzuni është më i mirë se rivalët si



El Arabi apo Igallo, edhe sepse ka mesatare më të mirë, me 0.41 gola për ndeshje. Duket se shqiptari ka lidhje të veçantë me Granadën. "Unë jam gjithmonë maksimumin kur luaj për këtë fanellë. Këtë e kam bërë edhe kur kam qenë i dëmtuar. Unë këtu ndihem si në shtëpinë time. Njerëzit më duan shumë, dhe

është e qartë se duhet t'ua shpërblej këtë mbështetje që më japin, duke shënuar gola. Unë jam i lumtur kur shënoj, jetoj për futbollin, dhe kjo është jeta ime". Ekzistojnë të gjitha mundësitë që Myrto Uzuni ta shkruajë historinë brenda këtij viti, pra të jetë shënuesi më i mirë për të gjitha kohët në Granadë.

Conor McGregor në gjyq më 5 nëntor, shtyhet sërish rikthimi i tij në kafaz apo në ring

DUBLIN, 21 TETOR - Conor McGregor, ish-kampioni i dyfishtë i botës në UFC, do të paraqitet para një jurie të Gjykatës së Lartë më 5 nëntor. Ai do t'u përgjigjet pretendimeve për sulm të supozuar prej tij, nga një incident në hotelin Beacon të Dublinit në vitin 2018. Irlandezi duhej të dilte para gjykatës në korrik, por asokohe avokatët e "the notorius" arritën të siguronin një shtyrje të seancës, për t'i lejuar McGregor të rikthehej në kafaz. Ai duhej të duelonte ndaj Michael Chandler në UFC 303 në Las Vegas, por sfida u anulua. Më pas McGregor kërkoi një shtyrje të dytë për një ndeshje boksi të paparalajmëruar, por kjo kërkesë u refuzua, pasi gjykata tashmë i kishte bërë atij një favor. Kjo do të thotë se ai do të detyrohet të shfaqet muajin e ardhshëm në Dublin, megjithëse është e paqartë se sa do të zgjasin procedurat ligjore. Drejtori ekzekutiv i UFC-së,



Dana White, e ka bërë tashmë të qartë se McGregor nuk ka gjasë ta bëjë rikthimin e tij në tetëkëndësh deri në fillim të vitit 2025. Kështu,

rikthimi i 36-vjeçarit në kafaz apo në ring, siç pretendon ai, do të shtyhet sërish pa afat deri në pranverën e vitit të ardhshëm.

SHKURT

Inzaghi: Herët të flasim për titull

Skuadra e Interit e fitoi derbin ndaj Romës në "Olimpico" me rezultat 0-1. Pavarësisht prej kësaj fitore, trajneri Simone Inzaghi qëndron me këmbë në tokë. "Këtë do ta thotë koha. Ekipet janë përforcuar shumë dhe të gjitha dëshirojnë ta fitojnë titullin, ashtu si Interi", ka thënë Inzaghi. Aktualisht kampioni i Italisë pozicionohet në vendin e dytë me 17 pikë, dy më pak se skuadra e Napolit që renditet e para.

Guardiola: Nuk jemi mësuar të fitojmë në këtë mënyrë

Manchester City arriti një fitore në minutat shtesë ndaj Wolverhamptonit (1-2) në "Molineux Stadium". Trajneri Pep Guardiola ka thënë se City nuk është mësuar të fitojë në këtë mënyrë. "Nuk jemi mësuar të fitojmë në këtë mënyrë, mbaj mend që Liverpooli në kohën e Kloppit fitonte ndeshjet në fund. Gjithsesi ky është një sinjal pozitiv, pasi tregon karakterin dhe vendosmërinë e skuadrës. Klasifikimi? Nuk e shoh asnjëherë, sidomos në këtë periudhë të sezonit, është shumë herët", ka deklaruar Guardiola.

Legjenda olimpike ndan lajmin e trishtë: Më kanë mbetur dy deri në katër vjet jetë

Gjashtë herë kampioni olimpik i çiklizmit, Sir Chris Hoy, ka njoftuar se po kalon vitet e fundit të jetës së tij. Në një intervistë me "Sunday Times", ai thotë se mjekët i kanë thënë se i kanë mbetur nga dy deri në katër vjet jetë. Ai ka thënë për "Sunday Times" se ishte diagnostikuar me kancer primar në prostatën e tij, i cili ishte përhapur në kockat e tij, që do të thotë se ishte në fazën e katërt. Legjenda e çiklizmit të skuadrës së Britanisë së Madhe, Sir Chris, dhe gruaja e tij Sara kanë dy fëmijë, Chloe 7-vjeçare dhe Callum 10-vjeçare. Sir Chris tregoi se si u ka thënë fëmijëve të tij se askush nuk jeton përgjithmonë, por ai shpreson të jetë këtu edhe për shumë e shumë vite të tjera.

Pogba e dëshiron edhe Al-Nassri

Paul Pogba do të largohet nga Juventusit gjatë afatit kalimtar të janarit si agjent i lirë, pasi pritet ta ndërpresë me marrëveshje kontratën e tij. Mesfushori i Juventusit, Paul Pogba, mori një shtyrje të madhe në karrierën e tij kohët e fundit kur ndalimi i tij për doping u reduktua ndjeshëm. Ai tani mund të fillojë të luajë ndeshje futbollit konkurruese nga marsi 2025 dhe të stërvitet me çdo ekip nga janari. Gjiganti francez Olympique Marseille po këmbëngul për transferimin e tij, megjithatë për Pogban ka dalë në skenë një tjetër destinacion. 31-vjeçari karrierën mund ta vazhdojë në Arabinë Saudite, ku Al-Nassri i Cristiano Ronaldos ka shprehur interesim për afrimin e francezit. Mediet franceze kanë raportuar se rol të madh për këtë po luan Cristiano Ronaldo, pasi e njeh mirë Pogban dhe aftësitë e francezit. Gjatë javëve të ardhshme pritet të ketë bisedime intensive mes drejtuesve të klubit arab dhe Pogbas, i cili do të jetë lojtar i lirë për të nënshkruar.

Kompany pas triumfit kundër Shtuttgartit: Radhën e ka Barcelona

Trajneri i Bayern Munchen, Vincent Kompany, ka dashur ta ulë euforinë pas triumfit ndaj Shtuttgartit me rezultatin 4-0. Ai ka lëshuar "kërcënim" në distancë për rivalin e

ardhëm, e cila përkon me Barcelonën këtë të mërkurë: "Duhej të kishim durim dhe nuk mund t'ia lejonim Shtuttgartit të kishte ndonjë kundërsulm. Kisha ndjenjën se

mund të punonim pak më mirë me shanset tona. Shtuttgarti është një skuadër e shkëlqyer. Ishte një paraqitje shumë e mirë. Pas pjesës së parë, gjithçka ishte për të

qëndruar i qetë. Jam shumë i kënaqur me rezultatin". "Ne kemi fituar dhe mund të festojmë pak përpara se të përballemi me Barcelonën. Jemi gjithmonë duke punuar

në detaje për të vazhduar përmirësimin. Radhën tani e ka Barcelona. Do të bëjmë gjithçka për të fituar kundër ekipit të Hansi Flick", ka deklaruar Kompany.



Shkolla e Mesme e Mjekësisë "ITALO KOSOVARE HIPOKRATI" Prishtinë bazuar në përgjegjësit e veta dhe duke respektuar Ligjin Nr. 06/0L-114, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, UA nr. 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe UA Nr.06/015 i normativit për mësimdhënësit e Arsimit Profesional, vendosi të publikoj këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës mësimdhënës të lëndës:

1. Gjuhë Shqipe
2. Ed.Fizike
3. Fizikë
4. Biologji
5. Kimi
6. Psikologji
7. TIK
8. Ndërmarrësi
9. Matematikë
10. Gjuhë Angleze
11. Gjuhë Gjermane
12. Kujdes shëndetësorë
13. Edukim shëndetësor dhe parandalim i infeksionit
14. Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut
15. Kujdes ndaj të sëmurave me sëmundje infektive
16. Farmakologji dhe dozologji
17. Shëndeti dhe sëmundjet e njeriut I dhe II
18. Kirurgji dhe përkujdesje
19. Shëndeti dhe sëmundjet të njeriut
20. Gjinekologji me obstetrikë
21. Biokimi klinike dhe diagnostikë laboratorike
22. Neuropsikiatri me kujdes
23. Mikrobiologji me imunologji
24. Kordinator të Cilësisë
25. Administratë
26. Bibliotekistë/ Arkivues
27. Fizioterapeut
28. Shtëpiak.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (merret në shkollë);
- Diploma (Çertifikata e diplomimit- nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e noterizuar nga organi kompetent;
- Ekstrakti i lindjes;
- Letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Vërtetimi nga gjykata se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për veprë penale (në raste kur krijon mardhënie pune e obliguar);
- Dëshmi të trajnimeve arsiore të akredituara nga MASHT-i (nëse ka).

Kushtet:

Për këto vende të punës kërkohet përgatitja adekuate profesionale, konform Udhëzimit Administrativ 10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe për shkollat e larta profesionale UA Nr.05/2015 i normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në kopje (dokumenti për kualifikimin profesional i noterizuar), të cilat nuk kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen me rastin e intervistimit.

Kandidatët që e kanë mbaruar shkollimin jashtë Kosovës duhet t'i kenë dokumentacionet e nostrifikuara.

Kandidatët që i plotësojnë kushtet do të ftohen në test me shkrim apo intervistë .

Njoftimi për datën dhe vendin e mbajtjes së intervistës do të bëhet përmes telefonit apo imellës së aplikantit.

Afati i aplikimit është 15 ditë nga data e publikimit në Imellën e shkollës:
Medicalschoolhipokrati@gmail.com apo në Objektivin e Poliklinikës Medika H në rrugën :

_____Muharrem Fejza,objekti I,NR.299 _afër rrethrotullimit Mati I/ Prishtinë.

Për qdo info. Kontaktoni në nr e tel: 043/ 882 525

Datë: 22.10.2024

Prishtinë

Ud. Drejtor

Dr.Sadbere Kamberi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zymber Berisha shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës fillore "Ali Kelmendi" Barilevë KK Prishtinë.

- Majlinda Vinarci shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismail Qemajli".

- Ridvan Shabani shpall te pavlefshme diplomën e SH.M.L.E. "Hasan Prishtina" ish shkolla "Silivira Tomasini".

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1

qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Soga" L.L.C. Suharekë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "Soga" L.L.C. Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.12.2024 në ora 11:00 në Shkollën Fillore e Mesme e Ulet "Vëllezërit Frashëri" në fshatin Bukosh, komuna Suharekë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Soga" L.L.C. Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Depo për grumbullimin e frutave malore, përpunimi, prodhimi dhe ambalazhimi i lëngjeve dhe ujit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Soga" L.L.C. Suharekë, për Depo për grumbullimin e frutave malore, përpunimi, prodhimi dhe ambalazhimi i lëngjeve dhe ujit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "VB CONSTRUCT" SH.P.K. me seli në Pejë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812160133 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "VB CONSTRUCT" D.O.O. Pejë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812160133 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "VB CONSTRUCT" L.L.C. with headquarters Pejë, has come to the decision to quit its business: 812160133 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "FIDANI BETON" SH.P.K. Deçan në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "FIDANI BETON" SH.P.K. Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.12.2024 në ora 10:00 në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Dëshmorët e Baballoqit" në fshatin Baballoq, komuna Deçan, do të organizohet debat publik nga Kompania "FIDANI BETON" SH.P.K., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Përpunimin, Thërrmimin dhe Seperimin e Rërës dhe Zhavorrit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "FIDANI BETON" SH.P.K. Deçan, për Depo për grumbullimin e frutave malore, përpunimi, prodhimi dhe ambalazhimi i lëngjeve dhe ujit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Muhamet Merovci" SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812175538 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Muhamet Merovci" D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812175538 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Muhamet Merovci" L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812175538 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

